



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Nr. 545/45Prot.

Tiranë, më 26.09.2016

V E N D I M

Nr. 116, Datë 26.09.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TIRANË “MBI
PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË DPD-SË
ME KRITERET DHE KËRKESAT E KUADRIT RREGULLATOR
NË FUQI”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DPD-së me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi”, për periudhën 01.01.2015-31.12.2015”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe detyrave të përbashkëta për zbatim midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe strukturave të varësisë së saj (*Degë Doganore dhe Laboratori Doganor*) është konstatuar se:

- Nga 25 “Masa organizative”, të rekomanduara nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 10 “Masa organizative”, **nuk janë zbatuar 11 “Masa organizative”** dhe janë në proces zbatimi 4 “Masa organizative”.

- Nga 11 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 152,405,100 lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka marrë në shqyrtim dhe ka zbatuar plotësisht 7 “Masa shpërblim dëmi”, si dhe ka marrë në konsideratë pjesërisht 4 masa “Shpërblim Dëmi” duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e tyre në shumën totale 6,570,173 lekë, ndërkohë që **nuk ka nxjerrë akte administrative për zbatimin dhe kontabilizimin e dëmit të rekomanduar për 4 “Masa shpërblim dëmi” për vlerën 145,834,927 lekë.**

- Është rekomanduar 1 “Masë administrative” e cila rezulton e zbatuar pjesërisht.

- Nga 8 “Masa Disiplinore” të rekomanduara rezulton se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka zbatuar “Masa disiplinore” për 4 punonjës dhe **nuk ka filluar asnjë procedim disiplinor për 4 punonjës.**

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 29-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Për rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme, të cilat rezultojnë të pazbatuara, në proces apo të zbatuara pjesërisht, trajtuar më hollësisht në faqet 29-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rikërkojmë zbatimin e tyre, si dhe informimin e KLSH-së, mbi masat e marra për zbatimin e tyre e konkretisht për rekomandimet e mëposhtme:

1.1.A Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa në zbatim të ligjit për respektimin e të drejtave të punonjësve të administratës së saj, në lidhje me kohëzgjatjen e kohës së punës. Në rastet e punës përtej orarit dhe në ditët e pushimit punonjësit duhet të paguhen me pagë shtesë në përputhje me kohëzgjatjen mbi orarin e punës, pasi mospagimi i tyre është me pasoja financiare për buxhetin e shtetit në një vlerë prej rreth 35,815,163 lekë (4,374,000 lekë shpenzime gjyqësore dhe 31,441,163 lekë paga shtesë) si rezultat i rëndimit të tij me shpenzime gjyqësore të fituara nga punonjësit e administratës doganore.

1.2.A DPD të dokumentojë vendimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, në zbatim të Manualin për MFK, pika 4.2.9, si dhe të merren masa që të kryhen trajnime të stafit mbi njohjen dhe procesin e implementimit të MFK-së.

1.3.A Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore Fier, Vlorë dhe Kakavijë të bëjnë një analizë të plotë për mosrealizimet dhe shkeljet ligjore, të

përcaktojë përgjegjësitë dhe masat përkatëse. Për realizimin e të ardhurave nga Taksa Kombëtare e Rentës Minerare, të hartojnë një program pune të detajuar, me afate e persona përgjegjës, sipas specifikave konkrete të çdo dege doganore dhe llojeve të mineraleve e nënprodukteve të tyre që eksportohen.

Në vazhdim të verifikimeve mbi zbatimin e këtij rekomandimi ka rezultuar se:

Rekomandimi i mësipërm, nuk ka gjetur zbatim as nga Dega e Doganës Vlorë, e cila ka patur korrespondencë, me Kontrollin e Lartë të Shtetit, në lidhje me këtë çështje. KLSH, në përgjigje të shkresës së Degës së Doganës Vlorë nr. 3159, datë 28.07.2016, mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1101/17, datë 06.05.2015 “Dërgim Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet” për auditimin e zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave e Degë Doganore “Mbi zbatimin e legjislacionit për rentën minerare”, ku paraqisni kërkesën “Për ndërhyrje institucionale lidhur me aplikimin e nenit 36 të Kodit Doganor, për vlerën e “Naftës bruto””, e ka bërë me dije Degën e Doganës Vlorë se: “...në materialin e sjellë nuk gjejmë fakte të reja mbi të cilat ju bazoni këtë observacion të përsëritur, të cilat nuk janë patur parasysh, apo për të cilat grupi i auditimit nuk kishte dijeni gjatë fazës së evadimit të materialit të auditimit”.

Ndërkohë që në referencë të shkresës nr. 29092/1, datë 07.12.2015 “Përgjigje për verifikim të faturave”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e ka informuar Degën e Doganës Vlorë se: “*Autoritet doganore Italiane kanë nisur një hetim të gjerë për monitorimin e transaksioneve të kryera midis “██████” dhe “██████” dhe për rregullsinë e transaksioneve do informojnë në përfundim të hetimit*”. Sa më sipër, KLSH ka konkluduar që, për sa kohë Dega e Doganës Vlorë, nuk ka një përgjigje nga Autoritetet Doganore Italiane në lidhje me hetimin e gjerë për monitorimin e transaksioneve të kryera”, rishqyrtimi i vendimit është fazë e ezauruar. Në këto kushte, ç’do veprim në kundërshtim me rekomandimet tona ligjore, në gjykimin tonë do të përbënte dëm ekonomik me dashje, kundër interesave të Shtetit.

1.4.A Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbështetur në çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, investigimit të tregut brenda dhe jashtë vendit, të bëjë azhurnimin dhe t’jua dërgojë Degëve Doganore të dhënat e disponueshme për çmimin e hekur-nikelit, të dhëna të cilësisë e përmbajtjes së tij.

1.5.A Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda afateve të përcaktuara të informojë Ministrinë e Financave, për shumën e arkëtuar të Taksës së Rentës Minerare sipas Degëve Doganore, subjekteve dhe NJQV-ve ku ushtrojnë aktivitetin këta subjekte. Në zbatim të ligjit për Buxhetin e Shtetit të përcaktojë shumën e fondeve që duhet alokuar për çdo NJQV.

1.6.A Dega e Doganës Durrës të marrë masa konkrete në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për largimin e mallrave të sekuestruara

(gomave dhe frigoriferëve të përdorur), nga ambientet e magazinimit provizor, sipas procedurave ligjore.

1.7.A Dega e Doganës Lezhë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat për të parë mundësinë e sistemimit në ambiente të tjera, pronë e enteve shtetërore apo ndërtimin e tyre me synim mënjanimin e shpenzimeve të tilla të mëdha që vazhdojnë të kryhen nga pagesa e lartë e qerasë 300 mijë lekë/muaj.

1.8.A Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i financës në Degën e Doganës Korçë në lidhje me të ardhurat dytësore, nuk rezultojnë të arkëtuara nga zëri i të ardhurave “Parkingu doganor”, sepse referuar kontratave të lidhura nga autoriteti doganor përfitues i tarifave të parkingut doganor, e përcaktuar 1,000 lekë për mjetet dhe 500 lekë për autoveturat, është subjekti qiradhënës, ku në total përfitimi i subjektit të sipërcituar nga Buxheti i Shtetit, vetëm nga tarifat e sipërcituara, për periudhën objekt auditimi, nga kontratat e lidhura me autoritetin doganor është rreth 8.6 milion lekë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 432, datë 28.06.2006 të MF “Për krijimin e të ardhurave dytësore që krijojnë Institucionet Buxhetore”, si dhe shkresës nr. 13119, datë 02.11.2006, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi caktimin e tarifave të të ardhurave dytësore në Administratën Doganore”.

1.9.A Ndjekja e rrugëve ligjore (Hartimi i Padive Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët gjyqësive, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

1.10.A Kryerja e regjistrimeve në kontabilitet nga Nëpunësi zbatues, (pas daljes së urdhrave administrativë), për vlerën e shpërblimit të dëmit dhe ndjekja e procesit të kryerjes së ndalesave në vazhdimësi.

1.11. B. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësive, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 41 raste në Degët Doganore Tiranë, Kakavijë, Berat, Korçë dhe Shkodër, për **vlerën 18,528,639 lekë**, nga subjektet sipas aneksit nr. 8.1, 8.2, 8.3 dhe 10.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015 si dhe anekseve 12.1-12.4, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

1.12. B. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degën Doganore Berat si strukturë e varësisë, të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e vendimit administrativ në **shumën 127,356,379 lekë** për **subjektin “██████████”** me NIPT **██████████** me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit sipas

aneksit nr. 8.3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015 si dhe aneksit 12.3, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

1.13. C. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të fillojë menjëherë procedurat për të kaluar në Komisionin Disiplinor, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda dhe të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 bazuar në nenin 58 germa “ç”, “largim nga shërbimi civil” për nëpunësit civil, **z. Dh Xh** me detyrë doganier regjime/përgjashtime në Degën e Doganës Berat, për **z. A H** me detyrë doganier i kontrollit fizik në Degën e Doganës Berat dhe për **z. E P** me detyrë ish-Kryetar i Degës së Doganës Berat si dhe bazuar në nenin 58 germa “b”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për nëpunësin znj. **A I** detyrë juriste e Degës së Doganës Korçë.

2. Nga auditimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe konkretisht, vlerësimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm, ka rezultuar se nuk janë zbatuar disa kërkesa të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” e konkretisht:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka hartuar Strategjinë e riskut; Gjatë vitit 2015, Grupi i menaxhimit Strategjik nuk ka funksionuar, pasi nuk është mbledhur asnjëherë (nga 4 herë të detyrueshme), për të diskutuar rreth evidentimit të risqeve të reja, për të analizuar dhe rivlerësuar ato, si faktorë që ndikojnë ndjeshëm në arritjen e objektivave;
- Titullari i institucionit, nuk e ka luajtur rolin e koordinatorit të riskut dhe as nuk e ka deleguar këtë kompetencë, rol i cili ka një rëndësi të veçantë në koordinimin e problematikave në lidhje me evidentimin e riskut, rishikimin e tij gjatë vitit, hartimin e regjistrit të riskut, si dhe marrjen e masave dhe procedurave shtesë për minimizimin e tij në nivel DPD-je.

Këto mangësi në funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, janë evidentuar edhe në auditimet e mëparshme, por që nuk kanë marrë vëmendjen e duhur nga niveli i lartë drejtues.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Titullari i institucionit, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme, për hartimin e Strategjisë së riskut, mbledhjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik të paktën 4 herë në vit, kryerjen e rolit të koordinatorit të riskut apo delegimin e tij një nëpunësi tjetër të nivelit të lartë drejtues, me qëllim funksionimin sa më të mirë të pesë komponentëve të kontrollit

të brendshëm, duke ndikuar ndjeshëm në mirëmenaxhimin e fondeve publike dhe rritjen e transparencës.

Afati: Menjëherë

3. Nga auditimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe konkretisht, vlerësimi të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm, ka rezultuar se nuk janë zbatuar disa kërkesa të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” e konkretisht:

- Nga Auditimi i Brendshëm, nuk është audituar në drejtim të monitorimit të riskut në DPD, si një prej dy metodave kryesore të këtij procesi, si dhe nuk janë vendosur rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku të specifikohet periodiciteti i verifikimit të këtyre sistemeve, si dhe procedurat për marrjen e masave riparuese;

- Nuk është kryer nga Auditimi i Brendshëm asnjë vlerësim mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në DPD. Për rrjedhojë nuk ka raportime tek Nëpunësi Autorizues e më tej, tek titullari mbi mënyrën e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në DPD. Titullari i institucionit nuk e ka angazhuar dhe dhënë rolin e duhur Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, mbi auditimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në DPD, gjë e cila do ti jepte siguri të arsyeshme stafit të lartë drejtues mbi mënyrën e menaxhimit të fondeve publike nga administrata doganore.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme për, rritjen e rolit të Auditimit të Brendshëm, si një strukturë tepër e rëndësishme në vlerësimin dhe monitorimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, pesë komponentëve të tij, në funksion kjo të arritjes së objektivave me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Afati: Menjëherë

4. Nga auditimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe konkretisht, vlerësimi të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm, si dhe nga auditimi mbi funksionimin e disa departamenteve dhe drejtorive operacionale gjatë vitit 2015, ka rezultuar se nuk janë zbatuar disa kërkesa të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” e konkretisht:

- Nuk janë hartuar hartat e proceseve të punës (sipas shtojcës 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit);

- Nuk janë përcaktuar të gjurmët e auditimit (shtojca 5 e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit);

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e urdhrimit për hartimin e hartave të proceseve të punës, si dhe përcaktimit të gjurmës së auditimit referuar përkatësisht shtojcës 3 dhe shtojcës 5 të Manualit të Menxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të gjitha funksionet dhe proceset kryesore të të gjitha

strukturave në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim lënien e gjurmës për çdo transaksion të kryer nga çdo punonjës.

5. Nga auditimi në lidhje me ligjshmërinë e saktësinë e ngjarjeve të kryera nëpërmjet veprimeve me arkën në lekë u konstatuan, mangësi e shkelje në pagesat e likuiduara për trajtimin financiar të punonjësve të aparatit të DPD, të dërguar me shërbim jashtë qendrës së banimit, pa dokumentacion shoqërues e justifikues dhe jo nëpërmjet veprimeve me bankë, në mospërputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 45-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Nga sektori i financës dhe kontabilitetit, të mos kryej asnjë pagesë për këtë qëllim nëpërmjet veprimeve me arkë, por vetëm nëpërmjet veprimeve me bankë.

Afati: Menjëherë

6. Nga audimi në lidhje me ligjshmërinë e saktësinë e ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në valutë u konstatuan, mangësi e shkelje në drejtim të rregullshmërisë së pagesave të likuiduara, për punonjësit e dërguar me shërbim jashtë vendit, pa miratim nga titullari institucionit qendror, pa dokumentacion shoqërues e justifikues, ose me situacion shpenzimi të përbashkët, si dhe jo menjëherë pas përfundimit të shërbimit, në mospërputhje me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe UKM nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të KM “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 45-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Nga Sektori i Financës e Kontabilitetit, të mos kryhet asnjë pagesë për këtë qëllim duke u bazuar në situacion shpenzimi të përbashkët, sikurse është proceduar deri tani, por vetëm me urdhër shërbim për secilin punonjës dhe bashkëlidhur pagesës të jenë të gjitha dokumentet justifikuese të shpenzimit të kryer.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

7. Nga auditimi në lidhje me ligjshmërinë dhe saktësinë e pagesave të kryera me veprimet nëpërmjet bankës, për shpenzimet e blerjeve të vogla dhe me emergjencë u konstatuan mangësi e shkelje në drejtim të rregullshmërisë së pagesave të kryera për blerjet e vogla, në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me pika 5, neni 29 “Procedurat standarde të prokurimit” e udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 45-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Nga Sektori i Financës e Kontabilitetit, të mos kryhet asnjë pagesë për këtë qëllim, në rastet kur dokumentet shoqëruese të blerjeve me emergjencë nuk pasqyrojnë kohën dhe vendin e kryerjes së blerjes, si dhe në të kundërt të trajtohen si blerje të vogla në kushte jo emergjente.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

8. Nga auditimi në lidhje me ligjshmërinë dhe saktësinë e pagesave të kryera me veprimet nëpërmjet bankës, për shpenzimet në pagesat e kryera për trajtim financiar të punonjësve të dërguar me shërbim, dieta ditore, udhëtim e fjetje në hotel jashtë qendrës së punës brenda vendit, për periudhën e përzgjedhur për auditim janë përlllogaritur e përfituar në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 45-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Nga Sektori i Financës e Kontabilitetit të mos kryhet asnjë pagesë, e cila nuk është e justifikuar me dokumentacionin shoqërues të shërbimit.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

9. Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, referuar kërkesave të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i shfuqizuar dhe ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit mbi “Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij ka rezultuar se, Drejtoria e Auditit të Brendshëm, për sa i përket zbatimit të procedurave të auditimit, në funksion të qëllimit të tij, **kryesisht është përqendruar në identifikim të gjetjeve me rezultat financiar, duke devijuar nga qëllimi dhe objekti kryesor i auditimit të brendshëm**, përcaktuar në nenin 7 të ligjit 9920, datë 23.04.2007 (i shfuqizuar) “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ku cilësohet: “Auditimi i brendshëm, si një proces dhe veprimtari e pavarur nga pikëpamja funksionale, vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozon masa, për të përmirësuar funksionimin dhe drejtimin e subjekteve të audituara”, si dhe në ligjin nr. 114/2014, nenin 6 “Roli i auditimit të brendshëm” cilësohet: “Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë”:

a) duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;

b) duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve;

c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme, që në hartimin e planeve vjetore të Auditimit të Brendshëm, të vlerësojë rolin e përcaktuar në ligj të kësaj strukture, duke e fokusuar auditimin në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e tyre në gjithë strukturat e administratës doganore, vlerësimin e riskut dhe dhënien e mbështetjes titullarit në arritjen e objektivave.

Afati: Menjëherë

10. Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, në auditimet e kryera gjatë vitit 2015, janë vlerësuar sistemet e kontrollit të brendshëm në njësitë e varësisë së DPD-së, si dhe janë trajtuar 5 komponentët e kontrollit të brendshëm si, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, komunikimi dhe monitorimi.

- Nga këqyrja dhe auditimi i praktikave të mësipërme, mbi auditimet e kryera në disa degë doganore, nga ana e audituesve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, janë konstatuar një sërë shkeljesh të cilat janë të lidhura ngushtësisht me funksionimin e 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm.

- Në trajtimin që i është bërë këtyre komponentëve si, mjedisit të kontrollit, menaxhimit të risqeve dhe aktiviteteve të kontrollit, në përgjithësi janë vlerësuar pozitivisht nga audituesit, ndërkohë që shumë gjetje në Raportet e Auditimit vijnë si rezultat i mosfunksionimit si duhet të këtyre komponentëve.

Kjo tregon që vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara, nuk ka qenë në koherencë me gjetjet dhe mangësitë e konsiderueshme të rezultuara në këto auditime.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 82-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa të menjëhershme që në Raportet e Auditimit të trajtohet në mënyrë rigoroze dhe sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualit në zbatim të tij, funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm si në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ashtu dhe institucionet e varësisë (degët doganore), duke vlerësuar në mënyrë të detajuar pesë komponentët përbërës të tij, mjedisin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, komunikimin dhe monitorimin.

Afati: Menjëherë

11. Nga auditimi ka rezultuar se, gjatë konstatimit të shkeljeve doganore në fushën e akcizës, në rastet kur janë evidentuar diferenca në mungesë të mallrave në magazinat fiskale të depozituesve të miratuar, nuk janë llogaritur dhe evidentuar detyrimet mbi TVSH-në që lidhen me vlerën e këtyre mallrave të munguar, kjo sipas përcaktimeve të ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, si dhe sanksionet respektive sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, për mallrat të gjetur në mungesë. Nga auditimi është evidentuar se, si rezultat i veprimeve në kundërshtim me

legjislacionin doganor, në 4 raste subjekteve ju kanë lindur detyrime të tjera tatimore sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Subjekti	NIPT	Detyrime TVSh-je	Te tjera	Totali
1			10,165,918		10,165,918
2			2,659,095	2,251,083	4,910,178
3		4,206,004		4,206,004
4		48,551,120		48,551,120
	Totali		65,582,137	2,251,083	67,833,220

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 156-186, Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

Departamenti Operativ-Hetimor dhe Departamenti i Akcizës, gjithë strukturat kontrolluese dhe konstatuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Degët Doganore Kompetente, gjatë hartimit të akteve të konstatimit, nxjerrjes së vendimeve doganore për kontabilizimin e detyrimeve të akcizës, të njoftojnë në mënyrë të detyrueshme Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi vlerën dhe sasinë e mallit të akcizës të gjetur në mungesë dhe të evidentojnë dhe detyrimet mbi TVSH-në, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar” dhe të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, për mallin e akcizës të gjetur në mungesë në Magazinë Fiskale të Depozituesve të Miratuar. Gjithashtu, rastet e mësipërme Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duhet t’ia përcjellë për shqyrtim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

12. Nga auditimi ka rezultuar se, gjatë konstatimit të shkeljeve doganore që cilësohen si kontrabandë, nuk është kërkuar sekuestrimi i mallrave objekt kontrabande, sipas përcaktimeve të nenit 281 pika 1,a, dhe 283 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nuk është plotësuar “Formulari i zgjidhjes administrative të kontrabandës” në zbatim të udhëzimit nr. 4 datë 30.09.1999, “Mbi zbatimin e dispozitave të parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor” dhe nenit 291 të Kodit Doganor në RSH.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 159-186, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

Departamenti Operativ-Hetimor, gjithë strukturat kontrolluese dhe konstatuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave si dhe Degët Doganore Kompetente, gjatë hartimit të akteve të konstatimit të shkeljeve doganore kontrabandë, nxjerrjes së vendimeve administrative doganore për kontabilizimin e detyrimeve doganore të shmangura të marrin në konsideratë të plotë përcaktimin e nenit 281 pika 1,a, 291 dhe 283 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimin nr. 4 datë 30.09.1999, “Mbi Zbatimin e Dispozitave të parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor” në lidhje me kërkimin e sekuestrimit të mallrave që kanë shërbyer si objekt kontrabande, në rastet kur kontrabanda rezulton e kryer e përfunduar, duke përdorur të gjithë mënyrat ligjore për kërkimin dhe sekuestrimin e këtyre mallrave objekt kontrabandë.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

13. Nga auditimi ka rezultuar se, nga Drejtoria e Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor, gjatë hetimit të shkeljeve doganore që janë cilësuar si kontrabandë që lidhen me subjektet “██████” dhe ██████ nuk janë kryer veprime të plota hetimore sipas përcaktimeve të neneve 281, 281/1 dhe 281/2 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nuk janë paguar të gjitha detyrimet doganore sipas kushtit të “Zgjidhjes administrative të kontrabandës” në zbatim të udhëzimit nr. 4 datë 30.09.1999, “Mbi zbatimin e dispozitave të parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor” dhe nenit 291 të Kodit Doganor në RSH.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 159-186, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtorja e Hetimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si strukturë e specializuar, që kryen veprime hetimore dhe ushtron të drejtën e ndjekjes penale pranë organit të Prokurorisë, për shkelje doganore të cilësuar kontrabandë të parashikuara në ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të kryejë veprime të thelluara dhe të mëtejshme hetimore, në lidhje me përgjegjësitë penale që mund të kenë kryer këto shoqëri, në cilësinë e kundërvajtësit, përveç rishikimit të pjesës së ndëshkimit administrativ për kontrabandën të rekomanduar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

14. Nga auditimi ka rezultuar se, nga Drejtoria e Kontrollit Paszhdoganimit pranë Departamentit Operativ Hetimor janë kryer kontrole mbi klasifikimin e mallrave që i përkasin kreut tarifor “3302” konstatohet se, për praktikat doganore të kryera janë konstatuar klasifikime të gabuara tarifore me pasojë mospagesën e detyrimeve doganore për artikullin “aromatizes frutash” të klasifikuar në kreun tarifor “33021090” me tarifë doganore bazë 2%, ndërkohë që duhej të klasifikohej në kreun tarifor “33021040” me tarifë doganore bazë 6% me destinacion përdorimi aromatizues “të një lloji të përdorur në industrinë e pijeve”, sipas shpjegimeve të kreut “3302” të Kapitullit 33 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 159-186, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave të saj të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në profil risku të artikullit “aromatizes frutash” i deklaruar në kreun “3302”, me qëllim mostrimin laboratorik dhe ndjekjen e procedurave doganore verifikuese të plota për saktësimin e plotë të destinacionit të përdorimit të këtij artikulli “të një lloji të përdorur në industrinë e pijeve” të klasifikuara në kodin tarifor “33021040” me tarifë doganore 6%, apo “të një lloji të përdorur në industrinë e ushqimore” të klasifikuar në kodin tarifor “33021090” me tarifë doganore 2%.

Afati: Menjëherë

15. Në të gjithë tenderat e zhvilluar në vitin 2015, përlogaritjet e vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit), nuk janë argumentuar në asnjë rast me dokumentacion përkatës, si dhe në rastet kur është cilësuar se çmimet janë marrë nga realizimi kontratave viti kaluar, bashkëlidhur ka vetëm oferta të shoqërisë pa lënë gjurmë në se kjo ofertë i takon kontratës së fituesit të tenderit në vitin referues. Edhe kur përcaktimi i vlerave limit është bërë me argumentim nga studimi i tregut, u konstatua mos dokumentimi i rregullt, si për shkresat dërguar kompanive për të dërguar oferta, ashtu dhe në përgjigjet e dhëna nga këto shoqëri, si dhe më e rëndësishmja është se asnjë nga ofertat e paraqitura, nuk ishte protokolluar në AK. Gjithashtu, në procesverbalet e hartuara nga grupet e punës nuk ka gjurmë për kryerje të veprimeve aritmetikore për fiksimin e vlerave limit të njoftimit të kontratës, si minimale, mesatare apo maksimale, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Kreu II “Organizimi i prokurimit publik”, neni nr. 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, neni nr. 41 “Dokumentet e tenderit” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, si dhe Kreu III “Dokumentet e tenderit”, neni 10.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 90-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

AK në të ardhmen të marrë të gjitha masat, që çdo përlogaritje e vlerës limit të njoftimit të kontratës (*fondi limit*) i miratuar për blerje, punë dhe shërbime të pasqyrohet me praktika të plota dokumentare zyrtare, duke i bërë pjesë të dosjes së procedurës së tenderit, pavarësisht nga volumi i tyre.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

16. AK me urdhra të veçantë krahas (NJP) ka ngritur edhe Grupe pune për përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret teknike e profesionale kualifikuese të operatorëve pjesëmarrës për procedurën e prokurimit, si dhe përlogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës, ndërsa njësia e prokurimit me procesverbal ka evidentuar e miratuar DST. Në raste të veçanta, nga Grupi i punës janë hartuar edhe kërkesat e përgjithshme të kualifikimit. Ngritja dhe funksioni i grupeve të punës, nuk ka qenë i argumentuar dhe mbështetur ligjërisht, sepse grupet e punës (struktura e posaçme prokurimi) përgatisin specifikime teknike, vetëm në ato raste kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura, ndërsa AK njësinë e prokurimit e ka ngritur në strukturë organike me kapacitetin e ndarje të qartë të detyrave. Për rrjedhojë ngritja e komisioneve është në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, Kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave” neni 57 “Njësia e prokurimit”, pika (2) “Njësia e prokurimit është përgjegjëse për...”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 90-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Autoriteti Kontraktor në të ardhmen të marrë masat, që ngritjen e çdo grupi pune për të përlogaritur vlerën limit të njoftimit të kontratës, si dhe specifikimet teknike, kriteret teknike e profesionale kualifikuese, t’argumentojë, si dhe vetëm për ato raste, kur Njësia e Prokurimit nuk funksionon në strukturë organike me

specialistë përkatës dhe nuk ka kapacitetin e duhur për të përllogaritur vlerën limit të njoftimit të kontratës (fondi limit), apo të hartojë specifikime teknike, kritere teknike profesionale e kualifikuese të operatorëve pjesëmarrës, duhet të miratojë ngritjen e komisioneve të veçanta.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

17. Nga auditimi në lidhje me argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit) në të gjitha procedurat, njësia e prokurimit ka miratuar e administruar në dosjen e prokurimit, përcaktimin e specifikave teknike, përllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës (fondi limit), kriteret teknike e profesionale kualifikuese të operatorëve pjesëmarrës, në raste të veçanta kërkesa të përgjithshme kualifikuese, ndërsa në procedurat e prokurimit me objekt e natyrë të përbashkët si: “Blerje pjesë këmbimi për mjete transporti”, “Mirëmbajtje mjete transporti e automjete” e “Blerje karburanti për automjete”, grupet e punës në argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës limit, nuk kanë pasqyruar me argumente e analizë të hollësishme, mbi numrin e mjeteve inventar në qarkullim, mbi sasinë e kilometrave që kanë përshkruar mjetet gjatë vitit paraardhës, mbi normativën e konsumit për 100/km të mjeteve e orë/punë për agregatët, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati (motogjeneratorë, kaldajë e motovedet), si dhe mbi vitin e prodhimit të mjetit e agregatit, veprime në mospërputhje me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuar nga neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2 germa “a; b” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe dispozitën VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 90-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

AK në të ardhmen të marrë masat, që për të gjithë procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, veçanërisht për ato me natyrë dhe objekt të njëjtë, argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të njoftimit të kontratës (*fondi limit*) të jetë pjesë përbërëse e administruar në dosjen e tenderit, e argumentuar për çdo procedurë prokurimi dhe e përllogaritur që në momentin e hartimit dhe miratimit të projekt/buxhetit të vitit përkatës.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

18. Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Vlerësimit Doganor, grupi i auditimit ka konstatuar se, në praktikën e përditësimit të “dosjes së të dhënave të disponueshme”, mungojnë të dhënat dhe dokumentacioni përkatës mbi indicien, për rivlerësim të të dhënave të disponueshme për një mall të caktuar, pra vendimmarrja për të shqyrtuar një artikull apo një tjetër është evazive, si dhe e pambështetur në një kërkesë, analizë të sektorit apo e dokumentuar me një studim apo të dhëna statistikore, ku të jepet informacion mbi trendin e çmimit të zhdoganimit në periudhat e mëparshme, në degë të ndryshme dhe nga subjekte të ndryshme, për një mall të caktuar, si dhe arsyen pse është i nevojshëm përditësimi.

- Gjithashtu, argumentimi, përshkrimi i të dhënave të përdorura dhe informacioni mbi përcaktimin e çmimit të ri, të një artikulli nuk është shoqëruar me dokumentacion përkatës, analiza dhe të dhëna statistikore, të cilat duhet të jenë pjesë e praktikave për çdo përditësim të kryer.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 3 dhe neni 12 “Përgjegjshmëritë menaxheriale të nëpunësve zbatues”, germa (dh), ku thuhet: “Mban përgjegjësi përpara NA për, dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi”, si dhe nenin 3.19 “gjurma e auditimit”, ku thuhet: “Gjurma e auditimit përfaqëson **rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre**, që synon të ripërshkojë të gjithë veprimtarinë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”.

- Nga auditimi është evidentuar se, për vlerësimin e vlerës doganore nga Departamenti Teknik dhe Drejtoria e Vlerësimit Doganor, nuk janë përcaktuar procedura të qarta, nuk ka ndonjë rregullore procedurash, udhëzim apo manual ku të përcaktohen kriteret, rregullat afatet etj, mbi rastet (indiciet) që referohet ky sektor për përditësimin e vlerës së një artikulli të caktuar, informacionin e nevojshëm mbi të cilin mbështetet për marrjen e një vendimi, aktet formale që duhet të mbahen, personat që duhet të përfshihen në një vendimmarrje për përditësim të vlerës, afatet për shqyrtim të tij nga sektori i vlerës, afatet e miratimit, si dhe aftin e përcjelljes në Degët Doganore për zbatim, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të neni 71, ku përcaktohet se ky sektor ka për detyrë të “Sigurojë që procedura e vlerësimit doganor të **mbështetet në kriteret të thjeshta të drejta** dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe praktika tregtare”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 132-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Teknik dhe Drejtoria e Vlerësimit Doganor, të marrin masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje, apo udhëzimi mbi mënyrën e procedimit dhe kriteret e vlerësimit doganor. Në rregullore, apo udhëzim të përcaktohen:

- a. burimet e indicies ku Drejtoria e Vlerësimit Doganor mbështetet për fillimin e një përditësimi të “dosjes së të dhënave të disponueshme”;
- b. afati në dispozicion të Sektorit të Vlerësimit Doganor, që prej kërkesës për kryerjen e përditësimi të “dosjes së të dhënave disponueshme”, deri në propozimin për ndryshim;
- c. burimet e informacionit, të dhënat, analizat statistikore, historikun e artikujve, mbi të cilat Sektori i Vlerësimit Doganor, mbështetet për argumentimin dhe vendimin për propozim të përditësimi të “dosjes së të dhënave të disponueshme”;
- d. të përcaktojë formatin e aktit të vlerësimit dhe të propozimit për përditësim të “dosjes së të dhënave të disponueshme”, ku të përshkruajë indicien apo

kërkesën për fillimin e procedurës, informacionin e mbledhur apo analizat e kryera për vlerësimin të kërkesës apo argumentim të indicies, të përshkruajë dokumentacionin dhe analizën e të dhënave mbi të cilat është mbështetur për marrjen e vendimit për propozim të përditësimit të “dosjes së të dhënave të disponueshme”, personat përgjegjës dhe hallkat e miratimit të tij.

Afati: Menjëherë

19. Nga auditimi është evidentuar se nga Sektori i Vlerësimit Doganor, nuk është bërë ndjekje periodike për artikujt e kodit 3901 dhe 3902 dhe 3904, sipas pikës 11 të udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, nuk ka gjurmë dokumentare, për ndryshimet e çmimeve nga një publikim i ri në atë paraardhës, për të faktuar ndryshimet me $\pm 10\%$ të vlerës midis tyre, sipas burimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, pika 10, si dhe udhëzimit nr. 6, datë 31.01.2013 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007”.

Nga Sektori i Vlerësimit Doganor nuk mund të faktohet, nëse është bërë azhornim i të dhënave sa herë ka patur ndryshim të vlerës së mallrave me $\pm 10\%$ kundrejt publikimit të mëparshëm, **për shkak të mungesës së aksesit në të dhënat e publikuara nga Kompania “████”, çdo 7 ditë dhe █████ dhe të përcaktuara në udhëzimet e cituara më lart si burime informacioni.** Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 3 dhe neni 12 si dhe nenin 3.19 “gjurma e auditimit”, ku thuhet: “Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjithë veprimtarinë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 132-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa të menjëhershme për sigurimin e aksesit në publikimet e çmimeve për artikujt e plastikës, të cilat publikohen nga Kompania █████, çdo 7 ditë, █████, me qëllim që azhornimi i të dhënave për lëndët e para plastike të klasifikuara në kodet 3902 “polipropilen”, 3901 “polietilen” dhe 3904 “PVC”, të kryhet sipas udhëzimit nr. 6, datë 31.01.2013 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007”.

Afati: Menjëherë

20. Nga lëshimi i Autorizimeve për Regjimin e Lejimit të Përkohshëm, për mos respektim afati, Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore ka aplikuar gjobë në masën 50,000 lekë për çdo rast të mos respektimit të afatit, në total për 16 subjekte në shumën 1,150,000 lekë. Për gjobat e vëna me shkresën nr. 12774, datë 18.05.2016 të DPD, nga kjo Drejtori ju është kërkuar Degëve Doganore respektive “që bazuar në procesverbalin e mbajtur të aplikohet gjoba e vendosur”. Në shkresën dërguar Degëve Doganore nuk citohet referenca ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 273/1, 2 e Kodit Doganor.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 132-159, Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore në përputhje e zbatim të Kodit Doganor nenit 273, pika 2, t’ju kërkojë Degëve Doganore respektive, që për 16 subjektet, sipas tabelën pasqyruar në faqen nr. 133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, vendosjen e një gjobë që shkon nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore, që duhen paguar për mallrat në fjalë.

Afati: Menjëherë

21. Nga lëshimi i Autorizimeve për Regjimin e Përpunimit Aktiv, për mos respektim afati kohor për rieksporim përcaktuar në autorizim, shkelje të kushteve të autorizimit në sasinë dhe vlerën e vlerësuar, Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore ka aplikuar gjobë në masën 50,000 lekë, për çdo rast, për 48 subjekte në shumën 2,500,000. Për gjobat e vëna me shkresën nr. 12774, datë 18.05.2016 të DPD, nga kjo Drejtori ju është kërkuar Degëve Doganore respektive, që bazuar në procesverbalin e mbajtur të merret vendim për vendosjen gjobave. Në shkresën dërguar Degëve Doganore nuk citohet referenca ligjore Kodi Doganor neni 287 pika 2, nuk janë përcaktuar rastet në numër të shkeljeve dhe specifika e tyre, duke mos u përcaktuar “germa” në pikën 3 të Autorizimit të shkelur, në kundërshtim me nenin 256/4 dhe neni 275 pika 2 të Kodit Doganor.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 132-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore në përputhje e zbatim të Kodit Doganor nenet 256/4 dhe 275/2, t’ju kërkojë Degëve Doganore respektive për subjektet që janë mbajtur procesverbale e vendosur gjobë, si në tabelën pasqyruar në faqet nr. 134-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, detyrimet doganore që duheshin paguar për mallrat objekt shkelje dhe për çdo shkelje ndëshkimi me gjobë në veçanti.

Afati: Menjëherë

22. Nga auditimi i Vendimeve të marra nga Sektori Juridik në lidhje me ankimimin e Vendimeve të Autoriteteve Doganore, në tre raste nga dosjet e audituara dhe të kthyera pa veprim, nga DPD megjithëse në shkresën kthim përgjigje citohen dokumentacion shoqërues nga ankimuesi në dosjen e arkivuar dokumentacioni mungon. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” neni 24 dhe Rregulloren mbi “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 15 të ligjit “Për Arkivat” nenet 19 dhe 21.

*Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 132-159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj:***

Drejtoria Juridike në çdo rast të ankimeve për vendimet e marra nga Autoritetet Doganore Kompetente të evidentojë dokumentacionin shkresor dhe në përfundim të afateve të dorëzohet praktikën në arkivë, si dhe dokumentacioni të renditet në mënyrë kronologjike, duke vënë në aktin e fundit shenjën “A/A” (akti në arkiv), datën e përfundimit të çështjes dhe nënshkrimin e zbatuesit.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

23. Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të evadimit të kontrolleve të kryera në çdo rast të konstatuar me shkelje, në zbatim të nenit 99 të ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë” Departamenti i Akcizës me shkresa zyrtare i ka dërguar Degëve Doganore praktikën me shkelje për marrje vendimi. Në Departamentin e Akcizës, nuk disponohet asnjë informacion zyrtar mbi vendimet e marra nga degët Doganore Mbikëqyrëse, për shkeljet e konstatuara, për pagesën e akcizës dhe për periudhën objekt auditimi, si dhe nuk ka asnjë verifikim për ekzekutimin dhe marrjen e vendimeve për shkeljet e konstatuara.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 186-193, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:

Departamenti i Akcizës, për të gjitha rastet e shkeljeve të konstatuara, nga kontrollet e kryera, të kërkojë në rrugë zyrtare Degëve Doganore aplikimin e detyrimeve dhe sanksioneve në përputhje me aktet e mbajtura gjatë kontrolleve, sipas vendimeve të marra dhe ekzekutuara nga Autoritet Doganore Kompetente.

Afati: Menjëherë dhe vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim **kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerat prej 91,274,257 lekë, të cilat në mënyrë analitike si më poshtë:**

1. Në 76 raste, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 88,578,109 lekë, nga e cila sipas aneksit nr. 3 “Drejtoria e Antikontrabandës” në vlerën 1,663,386 lekë, aneksit nr. 4 “Drejtoria e Hetimit” në vlerën 72,120,750 lekë, si dhe anekset nr. 5, 6 dhe 7 “Drejtoria e Kontrollit Paszhdoganimit” në vlerën 14,793,973 lekë, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, si rezultat i veprimeve në kundërshtim me kërkesat e nenit 256, 261, 271, 281 pika 1,a, 291 dhe 283, 289 dhe 291 dhe 293 sipas Ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005 për “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore, udhëzimit nr. 8 datë 30.12.2013 “Për zbatimin praktik të taksës së ambalazhit” i nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “Të dhëna të

disponueshme për shpenzimet e transportit” të Ministrit të Financave, ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar për mallin e akcizës të gjetur në mungesë në Magazinë Fiskale.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 159-186, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Afati: Deri 31.12.2016

2. Në 37 raste, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 763,670 lekë. Vlera prej 723,500 lekë, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë përfituar dhe kryer padrejtësisht pagesa më tepër, pa dokumente shoqëruese justifikuese, nga trajtimi financiar i punonjësve të aparatit të DPD të dërguar me shërbim brenda vendit, jashtë qendrës së punës, në kundërshtim me përcaktimet dhe kërkesat e parashikuara nga VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika 2. Gjithashtu, sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë përfituar e kryer pagesa padrejtësisht më tepër në valutë, pa dokumente shoqëruese justifikuese, përlllogaritje të gabuara, apo paradhënie të pa kthyer, nga trajtimi financiar i punonjësve të aparatit të DPD, të dërguar me shërbim jashtë vendit, në kundërshtim me përcaktimet dhe kërkesat e parashikuara nga VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” e UKM nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të KM “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Trajtuar më hollësisht në faqe nr. 45-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Afati: Deri 31.12.2016

3. Në 3 raste, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 160,960 lekë, sipas aneksit nr. 9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga AK nuk janë llogaritur e ndalur penalitet për mos realizim të sasisë së zërave të riparimit dhe vlerës së kontratave me objekte “Mirëmbajtja e sistemit të peshimit” dhe “Mirëmbajtja e pajisjeve të kontrollit, skanerat”, në mospërputhje me nenet “Përfaqësimi i palëve” dhe “Sanksionet” të përcaktuara në kontratat e lidhura midis palëve, ku kontaktuesit detyrohen të paguajnë penalitet në masën 2/1000 në ditë për vlerën e pa realizuar të kontratës nga data e situacionit dhe faturës së fundit, si edhe janë kryer pagesa me procedurë “blerje e vogël”, për gjoba të tejkalimit të afatit në kontrollit teknik për 6 targa automjeti, pagesë e pa justifikuar për qëllimin e kryer, sepse gjoba për tejkalim afati i ngarkohet drejtuesit të mjetit.

Trajtuar më hollësisht në faqe nr. 90-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Afati: Deri 31.12.2016

4. Në 6 raste, është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,771,518 lekë, sipas aneksit nr. 8 bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit, Degët Doganore nuk kanë vepruar për refuzimin e trajtimit preferencial dhe aplikimin e detyrimeve doganore se bashku me sanksionet.

Kjo ka rezultuar gjatë vërtetimit të certifikatave EUR.1, si për rastet kur nga autoritetet doganore homologe nuk ka ardhur përgjigje brenda 10 muajve nga data e kërkesës për verifikimin e provave të origjinë, dhe për rastet kur Degët Doganore janë njoftuar zyrtarisht për refuzim të trajtimit preferencial.

Trajtuar më hollësisht në faqe nr. 132-1159, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Afati: Deri 31.12.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 germa “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë menjëherë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

1. Neni 58 germa “ç”, “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Z. E. D, me detyrë Përgjegjës i Zyrës Peshore/Pike Kontrolli, në pikën doganore Goricë-Korçë, në cilësinë e ish. specialistit në Drejtorinë e Kontrollit Paszhdoganimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- për shkeljet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të program kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit dhe hartimit të akteve në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 8 datë 30.12.2013 “Për zbatimin praktik të taksës së ambalazhit” i nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të specialistit të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit referuar "Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" nr. 10168, datë 07.06.2011;

- për shkeljet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim të cilat kanë qenë pjesë e program kontrolleve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe që nuk janë marrë në konsideratë;

- për shkelje të konstatuara në lidhje me praktika doganore, me keq klasifikim tarifor, në kundërshtim me kërkesat e shënimeve dhe shpjegimeve të kapitujve respektivë dhe Rregullave të Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, miratuar me ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005 për

“Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore”, me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të KD, të cilat kanë qenë pjesë e program kontrolleve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. (*Trajtuar hollësisht në faqet 159-186 të RPA*).

II. Neni 58 germa “c-ç”, nga “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” deri në “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civil, si më poshtë:

2. Z. S A, me detyrë specialist i aposteriorit, në Degën Doganore Durrës, në cilësinë e ish. specialistit të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- për problemet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të program kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit dhe hartimit të akteve në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, udhëzimit nr. 8 datë 30.12.2013 "Për zbatimin praktik të taksës së ambalazhit" i nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare" i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të specialistit të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit referuar "Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" nr. 10168, datë 07.06.2011;

- për shkelje të konstatuara në lidhje me praktika doganore, me keq klasifikim tarifor, në kundërshtim me kërkesat e shënimeve dhe shpjegimeve të kapitujve respektivë dhe Rregullave të Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave e miratuar me ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005 për “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore”, me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të KD, të cilat kanë qenë pjesë e program kontrolleve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3. Z. E K, me detyrë Doganier i Zyrës së Klasifikim/Vlerësim/Kontroll fizik, në Degën Doganore Gjirokastër, në cilësinë e ish. Drejtorit të Hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

- për problemet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të dosjeve hetimore të Drejtorisë së Hetimit dhe hartimit të akteve në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të specialistit të Drejtorisë së Hetimit referuar "Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" nr. 10168, datë 07.06.2011, veprime jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e neneve 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289 dhe 291 të Kodit Doganor, në veçanti për “raste të përsëritjes së kontrabandës”.

4. Z. K N, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Klasifikimit/Vlerësimit, në pikën doganore Sarandë, në cilësinë e ish. Kryetarit të Degës Doganore Tre Urat, Përmet:

- për veprime të kryera në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-në nr. 205, datë 13.04.1999 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", veprime në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me nr. 19095/2, datë 12.11.2012, gjatë nxjerrjes së Vendimeve Administrative doganore, për veprime jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 281 pika 1/a, 291 dhe 283 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" në veçanti "sekuestrimi i objekteve të kontrabandës. (Trajtuar hollësisht në faqet 159-186 të RPA).

III. Neni 58, germa (c) "pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", si më poshtë:

- a. Në cilësinë anëtarit të grupeve të punës, për hartimin e specifikimeve teknike e përlllogaritjen e argumentimin e njoftimit të vlerës së kontratës (fondi limit), të ngritur me urdhra të veçantë nga titullari Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit (Blerje karburanti për automjete, Mirëmbajtja e pajisjeve të kontrollit, skanerat, Blerje pjesë këmbimi për mjetet e transportit të DPD, Mirëmbajtja e sistemit të peshimit dhe Mirëmbajtja e pajisjeve të kontrollit, skanerat), **për nëpunësit civil:**

5. Z.Sh C

6. Z.E L

7. Z.S A

8. Z.G D

9. Z.L K

10. Z. B

11. Z.S I

-për veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, gerrat "a" dhe "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu II "Rregullat e Përgjithshme të prokurimit" neni 9 "Llogaritja e vlerës së kontratës".

-sepse për argumentimin dhe përlllogaritjen e vlerave limit të njoftimeve të kontratave (fondi limit) për procedurat e prokurimit, detyrë e cila i përket njësisë së prokurimit, grupet e punës të ngritura me urdhër të brendshëm nga Autoritet Kontraktor, nuk dispononin të dhëna të plota e të mjaftueshme për të saktësuar e rritur efektivitetin, ekonomikitetin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike të prokuruar. (Trajtuar hollësisht në faqet 90-110 të RPA)

- b. Në cilësinë anëtarit të Komisionit të blerjeve të vogla (emergjencë), të ngritur me urdhra të veçantë nga titullari Institucionit në procedurat e ndjekura për blerjet e vogla, në pagesat e kryera nëpërmjet veprimeve me bankë, Z. Sh Ç, Z. S I dhe Z. S A.

-për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me pika 5, neni 29 “Procedurat standarde të prokurimit” e udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, (emergjencë).

-sepse në pagesat e kryera me veprime nëpërmjet bankës, për rregullshmërinë e shpenzimeve blerje të vogla, kanë miratuar çmime blerje me emergjencë, ndërkohë që prania e komisionit të blerjeve ishte i mundur të mbledhej normalisht, ndërsa dokumentet shoqëruese të blerjeve me emergjencë nuk pasqyrojnë kohën dhe vendin e kryerjes së blerjes që duhej të trajtoheshin si blerje të vogla dhe në kushte jo emergjente. *(Trajtuar hollësisht në faqet 90-110 të RPA).*

c. Në cilësinë anëtarit të Komisioneve të posaçme të ngritur me urdhra të titullarit për zbatimin e kontratave të lidhura me objekte (Mirëmbajtje pajisjeve të kontrollit, skanerat dhe sistemet e peshimit), për Z. S .A , Z. E. P dhe Z. E. L

-Për veprime në kundërshtim me nenet “Përfaqësimi i palëve” dhe “Sanksionet”, ku është parashikuar, që kontaktuesit detyrohen të paguajnë penalitet në masën 2/1000 në ditë, për vlerën e pa realizuar të kontratës nga data e situacionit dhe faturës së fundit.

-Sepse në kontratat e lidhura me subjektet e shpallura fituese, me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të peshimit” dhe “Mirëmbajtja e pajisjeve të kontrollit, skanerat”, nuk kanë llogaritur e ndalur penalitet për mos realizimin në sasi e vlerë të zërave të riparimit në kontratat e lidhura midis palëve për sistemin e peshimit dhe kontrolli skanerat. *(Trajtuar hollësisht në faqet 90-110 të RPA)*

IV. Neni 58, germa “b”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, për nëpunësit civilë:

12. Z. A H, me detyrë Komandant Grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

13. Z. E K, me detyrë detyrë Komandant Grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

14. Z. A F, me detyrë detyrë Komandant Grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

15. Z. A U, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

16. Z. P T, me detyrë Inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

17. Z. M C, me detyrë detyrë Inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

18. Z. J M, me detyrë detyrë Inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

19. Z. I Z, me detyrë detyrë Inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

- për shkeljet të përsëritura, të konstatuara gjatë kryerjes së detyrave funksionale dhe hartimit të akteve administrative, në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe

përcaktimeve të detyrave funksionale të Komandantit dhe Inspektorit të Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor referuar "Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" nr. 10168, datë 07.06.2011. *(Trajtuar hollësisht në faqet 159-186 të RPA).*

V. Neni 58 germa "b", "mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj", për nëpunësit civilë:

20. Z. Th N, me detyrë specialist i Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

- për shkeljet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore gjatë ushtrimit dhe përfundimit të program kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit dhe hartimit të akteve në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të specialistit të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit, referuar "Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" nr. 10168, datë 07.06.2011.

- për shkelje të konstatuara në lidhje me praktika doganore, me keq klasifikim tarifor, në kundërshtim me kërkesat e shënimeve dhe shpjegimeve të kapitujve respektivë dhe Rregullave të Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, miratuar me ligjin nr. 9461 datë 21.12.2005, për "Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore", me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, si dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të KD gjatë kryerjes së detyrave funksionale, mbi verifikime doganore të përzgjedhura, të cilat kanë qenë pjesë e program kontrolleve, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

21. Z. K. M, me detyrë specialist hetues pranë Drejtorisë së Hetimit në Departamentin Operativ-Hetimor .

- për shkeljet e konstatuara në lidhje me konstatimet jo ligjore, gjatë ushtrimit dhe përfundimit të dosjeve hetimore të Drejtorisë së Hetimit dhe hartimit të akteve në kundërshtim me ligjin nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, përcaktimeve të detyrave funksionale të specialistit të Drejtorisë së Hetimit referuar "Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave" nr. 10168, datë 07.06.2011, veprime jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e neneve 256.1.b, 256.2/3, 281, 281/1, 289 dhe 291 të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", në veçanti për "raste të përsëritjes së kontrabandës". *(Trajtuar hollësisht në faqet 159-186 të RPA).*

VI. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor ish-punonjësit e poshtë cituar:

1. Z. A A, në cilësinë e ish Kryetar të Degës Doganore Shkodër.

2. Zj. L N, në cilësinë e ish Kryetar Degës Doganore Lezhë.

3. Z. A A, në cilësinë e ish Drejtorit të Departamentit Operativ-Hetimor në Drejtorinë ë Përgjithshme të Doganave.
4. Z. V H, në cilësinë e specialistit të Drejtorisë së Kontrollit Paszhdoganimit në Drejtorinë ë Përgjithshme të Doganave.

VII. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësit: E K, E M, S L, D Sh, R D, I H, E H, E G, H Sh, E P, N S, B K, E B, T M, I P, O K, T S, MZ, M B, V V, I M, A H, është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R